



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR MAT

Nr.serie 00032

LEJE
PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR
Nr.prot 03/S, datë 10/3/2020
Miratuar me :
VENDIM TË KËSHILLIT TË BASENIT UJOR
Nr. 6, datë 03/03/2020

Emri i subjektit: "REDEN" SH.P.K
I regjistruar si subjekt me këto të dhëna: Nr.QKR (NIPT) K 87530901 G
Baseni Ujor: MAT
Qarku: DIBËR
Bashkia/Komuna: Njësia Administrative Lis, Bashkia Burrel
Koordinatat: KRRGJSH

Godina e HEC X 502567 Y 4607322 Z 165 m

Vepra e Marrjes X 505793 Y 4606606 Z 253 m

Lloji i aktivitetit dhe qëllimi Ujë për prodhim hidroenergjie "HEC GJONI"

Prurja mesatare: 2.68 m³/sek

Prurja ekologjike: 0.26 m³/sek

Sasia e ujit që jepet për përdorim: 3.22 m³/sek

Vëllimi i rrjedhës së kthyer (nëse ka) 3.22 m³/sek dhe vendi ku rrjedha e kthyer do të shkarkohet.

Vendi i shkarkimit të ujrave të përdorura, Lumi Mat

Sipërfaqja e tokës me të cilën lidhet përdorimi i ujit (në rastin e ujitjes) nuk ka (ha)

Kufizime në ushtrimin e veprimtarisë (nëse ka), Të mos kufizohet furnizimi me ujë të pijshëm, nevojat e bujqësisë në zonë dhe rezerva e domosdoshme ekologjike.

Periudha e vlefshmërisë 5 VJET

KRYETAR
GJOKË JAKU



Kushtet e Lejes

1. Të respektohet qëllimi për të cilin jepet kjo leje;
2. Të respektohen kushtet higjieno – sanitare dhe të mbrojtjes së mjedisit përreth;
3. Përdoruesi i ujit është i detyruar të vendosë matës ujit me shpenzimet e veta sipas rregullave që vendosin autoritetet e ujit;
4. Në rastet kur uji përdoret si produkt ushqimor, procedurat e prodhimit duhet të jenë konform rregullave të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave;
5. Burimi ujqor të shfrytëzohet nga zotëruesi i lejes;
6. Brenda 2 muajve nga pajisja me leje, subjekti duhet të fillojë veprimtarinë për të cilën është pajisur me leje;
7. Leja nuk mund t'i transferohet një subjekti tjetër pa miratimin e organeve kombëtare të administrimit dhe menaxhimit të burimeve ujore;
8. Të mos kryhen veprime që sjellin drejtpërdrejtë ose si pasojë, dëmtimin e burimit ujqor;
9. Subjekti të bashkëpunojë dhe të mos pengojë kryerjen e kontrolleve nga autoritetet përkatëse;
10. Subjekti të paraqesë çdo informacion, dokument dhe të japë çdo shpjegim lidhur me mënyrën e përdorimit të burimit ujqor;
11. Për shkeljen e kushteve të lejes, do të merren masa në përputhje me Kreun XIX të Ligjit nr.111/2012;
12. Zotëruesi i lejes paguan shpenzimet administrative dhe tarifën për ujin e shfrytëzuar, bazuar në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Ndryshimi ose anulimi i lejes

Kjo leje mund të ndryshohet pjesërisht ose të anulohet plotësisht, para mbarimit të afatit të përcaktuar, kur:

1. Përfituesi i lejes shkel njërin nga kushtet e parashikuara më sipër;
2. Organi kompetent për nxjerrjen e lejes bën azhurnimet përkatëse lidhur me burimin konform ndryshimit të planeve të burimeve ujore, ndryshim i cili prek edhe burimin ujqor, objekt i kësaj leje;
3. Kushtet e dhënies së lejes kanë ndryshuar;
4. Burimi ujqor është drejt shterimit;
5. Aktiviteti që ushtrohet, bazuar në lejen e dhënë, është shkak i ndotjes së burimit ose mjedisit;
6. Në qoftë se për shkak të forcave madhore ndodhin ndryshime në prurjen, cilësinë, kufijtë e burimit, etj, dhe këto ndryshime sjellin pamundësinë e përdorimit të tij nga zotëruesi i lejes, ky i fundit ka të drejtë t'i drejtohet organit kompetent, që i ka dhënë lejen, për ta anuluar atë;
7. Ka ndryshime të legjislacionit përkatës në fushën e ujërave dhe që prekin drejtpërdrejtë kushtet e kësaj leje.

Për ZABU Ishëm – Erzen - Mat

Drejtor
Anastasi Meçi



Për subjektin